



RREGULLORJA DHE PROGRAMI I NDESHJEVE

**"KAMPIONATI
MBAREKOMBETAR
EKIPOR 2021"**

1. RREGULLAT E PERGJITHSHME

1.1 Kjo rregullore permban menyren e garimit si dhe programin e gares per Kampionati Mbarekombetar Ekipor 2021.

1.2 Ne kete gare jane te vlefshme Rregullat e Shahut te FIDE dhe procedura e garave te Federates Shqiptare te Shahut.

2. Mënyra e garimit

2.1 Kampionati Mbarekombetar Ekipor 2021 do te zhvillohet me 9 raunde me ane te sistemit zvicerian te kompjuterizuar.

2.2 Koha e mendimit do jete 90 minuta + 30 sekonda shtese per cdo levizje duke filluar nga levizja e pare.

2.4 Ekipi perbehet nga 4 lojtar + 1 tavoline lojtar i ri deri ne 18 vjec (tavolin fix-e) ne total 5 tavolina si dhe dy lojtar rezerve.

2.5 Per cdo ndeshje, ne rast fitores merret 2 pike, barazim 1 pike dhe ne humbje 0 pike. Ne rast pikesh te barabarta sistemi qe percakton renditjen eshte:

- Ndeshja Direkte
- Piket e grumbulluara ne tavolina gjate turneut
- Buchholz Cut 1

2.6 Për të marrë diplomën e tavolinës shahisti duhet të ketë zhvilluar minimalisht 7 (shtate) ndeshje. Fituesi shpallet lojtari me raportin (pikë/ndeshje te zhvilluara) më të madhe. Ndeshja direkte midis tyre dhe me pas numri i ndeshjeve me te zeza.

. Rregullorja e brendshme

3.1 Kapitenët e ekipeve, për ndryshimet e bëra në formacion, janë të detyruar të dorëzojnë formacionin e ndryshuar tek gjyqtaria 1 ore pas pefundimit të ndeshjes paraardhese. Pas këtij afati, mbetet në fuqi formacioni bazë.

3.2 Kapiteni mund të komunikojë me lojtarët e ekipit të tij gjatë lojës vetëm në rastin kur në lëvizje është pala kundërshtare në prezencën e gjyqtarit.

3.3 Gjatë ndeshjes lojtari mund të drejtohet kapitenit për çështje që kanë të bëjnë me garën, gjithëmonë në prezencë të gjyqtarit.

3.4 Lojtarëve nuk u lejohe largimi nga salla e ndeshjes pa miratimin e gjyqtarit kur është ende duke luajtur. Lojtari nuk duhet të ketë me vete telefon celular apo ndonjë mjet tjetër elektronik. Nëse çfardo lloj mjeti prodhon apo lëshon tinguj, lojtari që e posedon e humbet lojën. Po ashtu gjatë ndeshjes, lojtarëve nuk u lejohe që të merren me çfardo lloj shënimesh, burime informative ose këshilla, si dhe të analizojnë në një tabelë tjetër të shahut, apo të konsultohen me shokë e me kolegë të klubit apo të tjerë për pozicionin e arritur në tabelë.

3.5 Lojtaret që janë deklaruar për tavolinën fix e të rinjve mund të luajnë vetëm në atë tavolinë, pra nuk kalojnë dot tek 4 tavolinat e tjera. Nëse njëri rregull ndjek edhe rezervë që është deklaruar për tavolinën e të rinjve. Nuk mund të luaj si reserve në tavolinat e tjera.

3.6 Ndalohet rreptesisht pirja e duhanit në sallë.

3.7 Lojtari ndalohet të komunikojë gjatë lojës.

3.8 Vonesa prej 15 minuta nga fillimi i raundit shkakton humbjen e lojës.

3.9 Mbajtja e maskes është e detyrueshme gjatë gjithë lojës.

3.10 Pas mbarimit të lojës lojtaret duhet të largohen nga ambjentet e gares.

3.11 Në sallën e lojës lejohen vetëm lojtaret, kapitenet dhe gjyqtaria.

5. GJYQTARIA

IA MARIN ÇOLLAKU

KRYE/GJYQTAR

IA BURHANUDIN MISINI GJYQTAR

IA AGIM SHEMSHIJI GJYQTAR

NA KRISTAQ ANDONI GJYQTAR

6. Komisioni i Reklamimit dhe reklamimet

Komisioni i reklamimit perbehet nga :

- 1) FA Benard Leka
- 2) Semi Numani
- 3) (Nje anetar i klubeve)

6.1 Reklamimi per ceshtjen duhet te behet deri 15 minutash pas perfundimit te ndeshjes qe po reklamohet me ane te nje kerkese me shkrim ndaj Gjyqtarise.

7. Programi Ndeshjeve

Data Ora

Turi I 02 Tetor 2021 16:00

Turi II 03 Tetor 2021 09:30

Turi III 03 Tetor 2021 16:00

Turi IV 04 Tetor 2021 09:30

Turi V 04 Tetor 2021 16:00

Turi VI 05 Tetor 2021 15:00

Turi VII 06 Tetor 2021 15:00

Turi VIII 07 Tetor 2021 15:00

Turi IX 08 Tetor 2021 10:00